



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br	282/18
Nr. i fq. / Br. st	- 19 -
Data: / Datum	25. 10. 2018
VUSHTRI - VUCITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCES SVE RBAL
NGA MBLEDHJA E -VIII- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27 SHTATOR 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifë, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrovë, Teuta Aruç Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Miljan Bojković.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës z.Xhafer Tahiri, nënkyretari i komunës – z.Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe përmarrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - paraqiti rendin e ditës lidhur me mbledhjen, duke prezantuar disa pika shtesë për inkorporim në rend të ditës, në pikën në të ndryshme. Pastaj bëri të ditur se pika e gjashtë e rendit të ditës me kërkesë të kryetarit të komunës është kërkuar që të hiqet nga rendi i ditës pasi duhet të merret mendimi ligjor nga agjencia e pyjeve.

Shpëtim Zhegrovë, anëtar i kuvendit – kërkoi informatë me shkrim nga kryetari i komunës lidhur me listën e inventarit të komunës para rrënimit të objektit të vjetër të komunës, pastaj listën e inventarit që ka mbet, si dhe vendimet për shpërndarjen e materialit nga objekti i rrënuar i komunës. Tute kërkoi informatë lidhur me memorandumin e nënshkruar mes komunës dhe kompanisë “Uniteti” për menaxhimin e mbeturinave (faturat dhe pagesat që janë bërë ndaj kësaj të fundit). Gjithashtu kërkoi informatë me shkrim edhe sa i përket memorandumit të mirëkuptimit mes komunës dhe Bashkësisë islame në Vushtrri sa i përket pagesave dhe kundërvlerave tjera karshi kësaj bashkësie.

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit – përsëriti se në Komitetin për Politikë dhe Financa, kishte kërkuar që të ofrohet një informatë me shkrim lidhur me ujin e pijshëm në komunën tonë, por një informatë e tillë nuk është ofruar në kuvend edhe pse për këtë kishte pasur një dakordim nga ana e komitetit. Në këtë kontekst ai vlerësoi se kjo çështje meriton një trajtim të posaçëm

pasi kemi të bëjmë me një temë jetike për qytetarët e komunës dhe apelon që kjo pikë e rendit të ditës të sillet në kuvend në mbledhjen e ardhshme.

Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 26.07.2018;
2. Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2019;
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për gjashtëmujorin e parë të vitit 2018;
4. Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e korrje-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QMF-së në Vushtrri;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për rialokimin/ transferin e mjeteve.
7. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Hartës zonale;
 - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e rrugës së re me emrin e “Shkelzen Sylës”;
 - c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.
 - ç). Shqyrtimi i Informatës për përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet për fillimin e vitit shkollor 2018/2019.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 26.07.2018

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 26.07.2018;

2. Shqyrtimi i Draft-buxhetit dhe planeve investuese për vitin 2019

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - tha se hartimit të buxhetit të komunës i ka paraprirë një proces i gjatë i zhvillimit të mbi 17 dëgjimeve buxhetore, ku kontributin e ka dhënë edhe KPF-ja dhe anëtarët e kuvendit, andaj tani është momenti final i aprovimit të këtij buxheti.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se buxheti si një instrumenti kryq, i cili paraqet prioritetet zhvillimore, rregullon të hyrat dhe shpenzimet për një vit fiskal, e që është proces i vazhdueshëm dhe përsëritet çdo vit, është karakterizuar në vazhdimësi me mungesë transparency dhe forma jo të duhura të raportimit. Bazuar në të dhënët e këtij dokumenti, mund të konkludohet se raportimi i shpenzimit dhe krijimit të buxhetit nga kjo qeveri është i mangët dhe nuk mundëson transparencën e shpenzimeve të parasë publike, rrjedhimisht dekurajon pjesëmarrjen publike duke anashkaluar edhe dëgjimet buxhetore të organizuara nga KPF-ja. Propozim-buxhetit komunal duhet të dorëzohet në Departamentin e Buxhetit në Ministrinë e Financave deri më dt.30 shtator 2018 dhe kërkohen dokumentet në vijim:

Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshtkuar nga Kryetari i komunës), vendimi i Kuvendit komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2019-2021, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare, tabela 4.1-Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2019-2021 (kopje e shtypur e vulosur, si dhe nënshtkuar nga kryetari i komunës dhe ZKF), tabela 4.2-Financimi i projekteve kapitale për vitin 2019, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare për vitin 2020-2021 (kopje e shtypur e vulosur, si dhe nënshtkuar nga kryetari i komunës dhe ZKF), tabela

4.3- Plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (kopje e shtypur e vulosur, si dhe nënshkruar nga kryetari i komunës dhe ZKF) dhe tabela e Buxhetimit të përgjithshëm gjinor e cila tabelë nuk na është dërguar fare dhe kërkoj sqarime pse nuk është me material dhe si do ta raportoni këtë dokument i cili nuk është pjesë e diskutimit buxhetor. Qarkorja buxhetore 01 dhe 02 përpos instruksioneve, kufijve buxhetorë të financimit, kërkon gjithashtu respektimin e afateve kohore për miratim të projekt-buxhetit të vitit 2018. Kjo qeveri duke tentuar të formulojë buxhetin komunal, ka provuar që copy-paste të hartojë buxhetin nga parapraku, mirëpo kryetar kopjimin e keni të dobët, thjesht ky buxhet nuk është në harmoni as me kërkesat e nevojat e qytetarëve, as me Qarkoren buxhetore, e as nuk është buxhet zhvillimor. Kryetar si është e mundur të propozoni sipas tabelës 4.1 me Planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2019, vetëm te zyra juaj kodi i programit 16024 zyra e kryetarit të shpenzoni në total 324.492,00€ si do ta arsyeton këtë kur dihen deklarimet tuaja të shpenzimeve javore. Ky Draft-buxhet komunal për vitin 2019 në formën e propozuar nuk duhet të kalojë për faktin se përveç se nuk është buxhet zhvillimor, i njëjtë nuk përputhet në shumë kategori ekonomike dhe nuk përputhet as me Qarkoren buxhetore. Në faqen 2 totali i kategorive ekonomike paraqitet të jetë 19.119.355,00€ kurse nëse llogariten drejt, vlera reale është 19.049.355,00€ dhe këtu kemi gabimin, gjegjësisht diferencën fiks 70.000,00€. Ky deformim duhet të rregullohet në mënyrë që të mos treten 70.000,00€ dhe te kategoria Subvencione dhe transfere të korrigohen totali duke respektuar Qarkoren buxhetore dhe duhet të jetë 192.914,00€. Të hyrat vetanake sipas Qarkores buxhetore për vitin 2019 janë: 2.546784,00€ kurse neve na ofrohet sipas tabelës 4.1 te Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve vlera 2.609.784,00€ çka rrjedhimisht prodhon defektin dhe krijon diferencën në vlerën prej 63.000,00€. Kjo diferencë do të ketë konotacion dhe mosbarazim te tabela 4.1 që reflekton edhe te tabela 4.2 (investimet kapitale), si dhe në tabelën 4.3 te të hyrat vetanake. Tabela 4.1 përpos mosbarazimeve ka edhe defekte tjera. Nr. i punëtorëve këtu paraqitet 1.586, kurse në Qarkoren buxhetore janë 1.587, përveç kësaj për të qenë edhe më joprofesional, ky draft buxhet në shkresë nuk ka raportime fare për minusin e pagave. Pagat dhe mëditjet në arsim sipas Qarkores buxhetore janë 7.025.359,00€, kurse në tabelën 4.1 Paga dhe mëditje për arsim nga Granti qeveritar paraqiten 7.013.062,00€ dhe në këtë vlerë është llogaritur edhe vlera prej 85.085,00€ në administratën e arsimit e cila vlerë nuk financohet nga Granti qeveritar për paga, këtu del një diferencë prej 97.382,00€.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së - tha se buxheti i komunës është hartuar konform Qarkores buxhetore. Pastaj shtoi se tabelat buxhetore janë të futura në BDMS dhe PIPA që janë të sakta dhe hartuar me përpikëri ku në lihet mundësia për jobarazime financiare.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se draft-buxheti për vitin 2019 është një buxhet i kompletuar dhe i njëjti është në interes të qytetarëve, ku në të janë paraparë projekte madhore që dallojnë nga vitet e kaluara, ndër të tjera ai përmendi tri si më kryesore, që beson që këtyre projekteve është dashur t'i gëzohen të gjithë, siç është projekt i përfunduar i stacionit të autobusëve, tregu për prodhim vendor ,shujta për nxënësit etj. Në fund tha se gjithçka është e qartë sa i përket këtij draft-buxheti dhe apeloi që ta votojnë të gjithë.

Habibe Gérxhaliu, anëtare e kuvendit – në emër të banorëve të fshatit Studime adresoi siç e dimë të gjithë, fshati Studime përkundër pasojave qe ka përjetuar, banorët vazhdojnë të përballën me mungesë atë kushteve elementare sa i përket infrastrukturës dhe rrugëve, kanalizimeve, si dhe hapësira të nevojshme për fëmijë parashkollarë. Sa i përket infrastrukturës rrugore, konkretisht është fjala për rrugën “Fatmir Ejup Gérxhaliu” e cila gjendet në segmentin e rrugës “2 Maji”. Kjo rrugë ka një gjatësi vetëm 130 metra, ndërsa e frekuentojnë rreth 50 banorë me afro 14 shtëpi. Përkundër kërkesave të mëhershme për shkak të prioriteteve të mëhershme nuk ka mund të realizohet ende. Gjithashtu më herët është bërë kërkesë që të zgjerohet ura të cilën e përdorin edhe shërbimi i zjarrfikësve, gjë që nuk i plotëson nevojat elementare. Kësaj rruge gjithashtu i mungon trotuari sipas nevojave, si dhe ndriçimi publik. Po ashtu rrugëve të Studimes së Ulët i mungojnë rrjeti i mirëfilltë dhe i përfunduar i kanalizimit. Fshati Studime, bazuar në numrin dhe strukturën e banorëve të tij ka nevojë për një çerdhe të

fëmijëve si një kërkesë elementare, si dhe paralelet për nxënës parashkollorë. Me iniciativë të banorëve janë adresuar kërkesa për pastrimin e hapësirave ku bëhet grumbullimi i mbeturinave dhe këto hapësira përvëç që mund të pastrohen ato mund të përdoren si vende të gjelbëruara e pse jo është hapësira ku mund të përdoren për vendosjen e lojërave për fëmijë apo të ngjashme. Unë si këshilltare e asamblesë komunale i drejtohem drejtoreive përkatëse komunale, që në bashkëpunim me banorët e fshatit të bëhen përgatitjet dhe planifikimi i projekteve në fjalë, me qëllim të realizimit të këtyre kërkesave për vitin 2019. Banorët e fshatit janë të gatshëm të takohen me autoritete komunale, t'i shpalosin kërkesat në mënyrë konkrete, si dhe të participojnë në bazë të mundësive materiale.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - duke iu referuar parafolëses së tij lidhur me kërkesat e banorëve të fshatit Studime, vlerësoi se në atë lokalitet ka mjaft probleme infrastrukturore nga e kaluara, për faktin se atje është bërë projekti për kanalizim, mjetet financiare janë paguar, ndërkaq kanalizimi nuk është bërë dhe për këtë ai i ka inkurajuar banorët që ta denoncojnë këtë rast. Tështo se për herë të parë janë planifikuar projekte për fshatin Studime ku janë planifikuar mjete financiare për ndërtimin e dy urave, njëra në fshatin Studime, kurse tjetra në fshatin Stanoc i Epërm. Pastaj njoftoi se në bashkëpunim me Agjencinë për Mbrojtjen e Memorialeve, komuna ka bërë një kërkesë për projektin për rregullimin e varrezave të martirëve në fshatin Studime, për faktin se asnjë investim nuk është bërë në këto varreza për kaq shumë vite. Mandej në kuadër të fondevë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, janë paraparë fonde për rregullimin e memorialeve edhe në qytet. Në fund tha se duke e marrë përbazë që kemi të bëjmë me një buxhet gjithëpërfshirës dhe në interes për qytetarë, atëherë ai duhet të përkrahet nga të gjithë anëtarët e kuvendit.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit – deklaroi në emër të grupit kuvendar të LVV-së se në bazë të rekondimeve të dala nga KPF-ja, si grup do ta përkrahin aprovimin e Draft-buxhetit të komunës për vitin 2019.

Sadije Bajgora, anëtare e kuvendit – tha se buxheti i komunës për vitin 2019 është gjithëpërfsirës dhe si të tillë Lëvizja për Bashkim do ta përkrah.

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit – tha se sa i përket investimeve kapitale duhet të ketë kujdes sidomos në shpërndarjen e projekteve që të kemi një barabarësi, sidomos në projektet themelore bazike për qytetarët, siç janë rrugët, kanalizimi dhe rrjeti i ujësjellësit. Pastaj vlerësoi se nuk mund të krenohemi edhe aq me këtë buxhet kur dihet fakti se mbi 10 milionë të këtij buxheti shkojnë për paga dhe mëditje dhe kështu këtij buxheti nuk mund t'i themi se është buxhet zhvillimor. Në fund tha se me qëllim të kryerjes së obligimeve ndaj qytetarëve, do ta përkrahin këtë draft-buxhet me rekomandimet e bëra në Komitetin për Politikë dhe Financa

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – kërkoi që të përmirësohet gabimi teknik tek projekti ndërtimi i lapidarit për Batalionin e I-rë të Brigadës 142 ku brigada është shënuar si 141.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit – në emër të Nismës Socialdemokrate e përkrahin Buxhetin e komunës për vitin 2019.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – pyeti se a është bërë identifikimi i projekteve lidhur me

shkollat, kanalizimin dhe ujësjellësin dhe a është bërë paramasa dhe paralogaria për këto projekte. Pastaj ceku se nuk e di se strukturat komunale a kanë dalë në vendngjarje për t'i shikuar shkollat, si p.sh ajo në fshatin Bivolak, Beçiq dhe Dobërrlukë, të cilat janë në gjendje katastrofale ku për këtë kërkoi që të intervenohet. Mandej tek renovimi i QMF-ve, pyeti se a është bërë identifikimi se cilat qendra kanë nevojë të rinovohen, a janë bërë përllogaritjet se sa kushtojnë këto renovime.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - paraqiti sqarime lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësi i tij dhe propozoi që informata e arsimit vitin e ardhshëm të planifikohet për muajin tetor.

Sylejman Mehollı, drejtor i DSHPS-së – paraqiti sqarime lidhur me pyetjet e bëra nga anëtarë i kuvendit z. Safet Idrizi. Pastaj ai vlerësoi se si shkak i mungesës si investimeve në infrastrukturën shëndetësore dhe mënyrës joprofesionale të kryerjes së punëve, gjendja në infrastrukturën shëndetësore është e keqe dhe kjo intreferon edhe në ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se nuk dëshiron të merret me akuza e as me kundërakuza, dhe shtoi se duhet të kihet kujdes sidomos gjatë pranimit teknik të objekteve shëndetësore. Në vazhdimësi kërkoi që gjatë hartimit të projekteve për ndërtimin e QMF-ve dhe AMF-ve duhet të planifikohen hapësira (anekse) për lëndë djegëse jashtë objektit shëndetësor, me qëllim që këto objekte të ruhen nga dëmtimi i tyre.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit – tha se është mirë që qeveria komunale e ka kthyer vëmendjen për investime në fushën e shëndetësisë, pasi që një kohë të gjatë shëndetësisë në komunën tonë nuk i është dhënë prioritet. Tute ai falënderoi strukturat komunale që po bëjnë përpjekje për rritjen e investimeve në shëndetësi në komunën tonë.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se në këtë mbledhje plenare të kuvendit nuk kemi rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa lidhur me Buxhetin e komunës për vitin 2019, por megjithëkëtë po shihet që ky draft-buxhet është i stilit copy-past i projekt-buxhetit të hartuar nga PDK-ja, përjashtuar projektin për stacionin e autobusëve dhe atë të tregut, të gjitha projektet tjera kanë qenë të planifikuara nga PDK - Dega në Vushtrri, andaj në këtë rast grupei kuvendar i PDK-së do ta mbështes me votë këtë draft-buxhet.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 32 vota “për” 1 votë “kundër” dhe 2 “abstenime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, KAB-i dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2019-2021, konform Qarkoreve Buxhetore 01/2019 dhe 02/2019 të lëshuara nga MF-ja.

2. Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2019 është 19,119,355.00 €, prej të cilave për:

2.1 Paga dhe mëditje.....	10,207,561.00 €
2.2 Mallra dhe shërbime.....	3,083,496.00 €
2.3 Shpenzime komunale.....	309,035.00 €
2.4 Subvencione.....	192,914.00 €
2.5 Shpenzime kapitale.....	5,326,349.00 €
Gjithsej:.....	19,119,355.00 €.

3. Të hyrat vetanake të planifikuara.....2,546,748.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 01/2019 dhe 02/2019 të MF-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoretit të tjera kompetente komunale.

6. Tabela 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2019; tabela 4.2 – investimet kapitale në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2019-2021; tabela 4.3 - të hyrat vetanake të komunës, si dhe tabelat e buxhetimit të përgjithshëm gjinor janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit dhe i njëjtë i dorëzohet Ministrisë së Financave për zbatim.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - pasi falënderoi anëtarët e kuvendit për votën "për", aprovimit të buxhetit të komunës, vlerësoi se ky buxhet është buxhet zhvillimor ku është rritur përqindja në investime kapitale në masën prej 43.29 %, ndërsa për bujqësinë kemi rritje prej 18.45% dhe kjo është një zotim i qeverisë komunale i dhënë përpara qytetarëve për përmirësimin rrënjosor të gjendjes në arsim dhe shëndetësi dhe po ashtu për ta vazhduar përkrahjen e madhe për buqit dhe për bujqësinë në Komunën e Vushtrrisë. Pastaj adresoi se është shumë i lumtur që komuna ka vendosur që t'ia kthejë qytetarëve të Vushtrrisë stacionin e autobusëve dhe një investim kaq i madh për 70 mijë qytetarët e komunës ndodhë njëherë në 50 vite, mandej tregu për prodhuesit vendorë për herë të parë qeverisja komunale po e përkrah në mënyrë të drejtpërdrejt bujqësinë dhe prodhuesit vendorë me këtë projekt po mënjanohen shitësit ambulativ në skaje të rrugëve që i rreh shiu e i than dielli, kështu do të kemi një vend të dinjitetshëm për shitësit dhe për produktet e tyre. Në kuadër të buxhetit gjithashtu do të kemi sigurim të mjeteve për shujtat e nxënësve, dhe mjetet financiare për ndërtimin e shkollës së muzikës, mandej planifikimi i mjeteve për ndërtimin e palestrës sportive e shumë projekteve tjera dhe të gjitha këto janë instrumente për përkrahje të drejtpërdrejt të qytetarit qoftë për bujkun, shitësin (tregtarin) dhe përkrahje e drejtpërdrejtë e fëmijëve dhe të rinjve tanë. Pastaj ndërtimi i tri fushave sportive është përkrahje e drejtpërdrejt e sportit dhe të rinjve, por edhe përkrahje e klubit sportiv, pavarësisht se klubi është udhëhequr nga eksponentë politikë të një partie politike. Tutje njoftoi se shumë shpejt në kuadër të këtij buxheti do ta kemi vendimin për ndërtimin e objektit të ri të QMF-së, dhe për këtë ekziston një marrëveshje mes komunës dhe Ministrisë së Shëndetësisë që ata të na ndihmojnë në ndërtimin e objektit të QMF-së, në mënyrë që ne t'i japim atyre objektin që ndodhet në oborrin e Spitalit të Vushtrrisë dhe ky projekt mendohet të përfundohet për një afat me më pak se tri vite. Objekti i ri i QMF-së mendohet se do të përfundohet afér shkollës "Mustafë Venhari" dhe kjo do të ndikojë në shkarkimin e qytetit dhe në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët tanë. Kështu marrë në tërësi ky buxhet është buxhet zhvillimor dhe i hap rrugë transformimit të qytetit të Vushtrrisë që e hap perspektivën e zhvillimit dhe të përkrahjes për rininë, për shëndetësinë, për arsimin dhe për buqit e qytetit të Vushtrrisë, prandaj për këtë i falënderoj të gjithë që kontribuan

3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për gjashtëmuajrin e parë të vitit 2018.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se e ka lexuar me vëmendje raportin në fjalë dhe e gjëzon fakti për realizimin e projekteve të planifikuara më herët dhe pyeti se a janë shpenzuar mjetet financiare nga kategoria e pagave dhe mëditjeve, dhe nëse ka suficit në lëmin e shëndetësisë, atëherë është mirë që të bëhet rekrutimi i resurseve humane në lëmin e shëndetësisë pasi ka nevoja të mëdha në këtë segment. Në këtë relacion ai vlerësoi se është mirë që të shpallen procedurat e rekrutimit të stafit nëse ka mjete, me qëllim që ato mjete mos të shkojnë në suficit në Qeverinë e Kosovës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se tek planifikimi urban dhe mjedisi, realizimi i buxhetit është në masën prej vetëm 2% dhe kjo është mjaft shqetësuese për faktin se në fundvit mjetet do të shkojnë në suficit në qeverinë qendrore. Pastaj e njëjta situatë është edhe në Drejtorinë për Kulturë dhe atë për Shërbime Publike ku mjetet nuk janë shpenzuar dhe kjo nuk tregon ndonjë sukses, andaj për këtë kërkoi sqarime nga drejtorët kompetentë.

Lutfi Gërguri, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime lidhur me temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se nëse e shikojmë situatën ekonomike të komunës për këta gjashtë muajt e fundit, është inkurajuese që në sektorin privat kemi pasur hapjen e 145 bizneseve të reja, kurse janë shuar vetëm 29 prej tyre dhe kjo nënkupton se ndërmarrësja private ka një zhvillim të qëndrueshëm dhe një rritje konstante në komunën tonë. Mundësitet e komunës për t'i mbështetur këto biznese janë të limituara dhe të gjithë jemi koeshientë për këtë. Lidhur me këtë komuna këtë vit për herë të parë ka startuar me financimin e kamatës për bizneset prodhuese dhe agrobizneset e komunë sonë. Ky është një projekt tepër interesant dhe për këtë inkurajon anëtarët e kuvendit që të përhapin fjalën tek bizneset e Vushtrrisë që bizneset të marrin një hua nga banka me qëllim të rritjes së biznesit, ndërkohë që komuna e mbulon normën e interesit. Nëpërmjet këtij instrumenti do të lironen mbi 1 milion euro për bizneset e Vushtrrisë dhe ky është një impuls shumë i madh për zhvillimin e ndërmarrësisë private. Zhvillimi ekonomik varet nga ndërmarrësja private dhe për këtë komuna ka bërë licencimin e zonës ekonomike në Lumadh, ku është shpall tenderi për revidim nga MTI-ja, ndërkohë që deri në fund të vitit pritet që të investohen afér 400,000.00 € në këtë projekt. Këto mjete nuk ishin të planifikuara nga qeveria e kaluar kommunale, por që ato u siguruan falë bashkëpunimit të mirë që kemi pasur me Kuvendin e Kosovës, përmes amendamentit në buxhet dhe për këtë falënderon të gjithë që kanë ndikuar në zhvillimin e këtij projekti. Ka një interesim tepër të madh të bizneseve private për t'u vendosur në këtë zonë dhe kjo sigurisht se do të ndikojë në zhvillimin e ndërmarrësisë private në komunën tonë. Po ashtu komuna ka hapur dhe iniciuar një projekt për zhvillimin dhe përkrahjen e bizneseve dhe start up, ku 63 biznese janë përzgjedhur në një procedurë transparente për t'u përkrahur me mjete të punës nga komuna në shumë afér 100,000.00 € dhe kështu janë dy masa konkrete të komunës në vlerë prej 600,000.00€ vetëm këtë vit për përkrahje të biznesit që krijon vende të reja të punës në Vushtrri. Një lajm tepër i mirë për komunën tonë është se Qeveria e Kosovës ka aprovuar vendimin për eksproprijimin e tokave private që shtrihen në zonën e minierës së Dubocit dhe Galicës dhe më 4 titor në këtë sallë do të mbahet debati me qytetarë për shpronësimin e atyre pronave dhe kështu do të kemi një investim privat që do të gjenerojë 200 vende të punës në minierën e Galicës. Ky projekt do të ndikojë në zhvillimin dhe hovin e sektorit minerar dhe krahas zonës ekonomike në Lumadh do të janë dy lajme shumë të mira për ekonominë e qytetit tonë. Në fund lidhur me shpenzimet buxhetore kommunale tha se ka kërkuar dhe kërkon nga drejtoret komunalë që të janë të kujdeshëm dhe transparent sa i përket shpenzimit të parasë publike.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime aaprovoi Raportin për situatën ekonomiko-financiare dhe zbatimin e planeve investuese për gjashtëmuajrin e parë të viti 2018.

4. Shqyrtimi i Informatës përfundimin e korrije-shirjeve dhe përgatitjet për mbjelljet vjeshtore.
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacionit përdërtimin e objektit të QMF-së në Vushtrri.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se ndërtimi i një objekti të ri të QMF-së, vërtetë është një lajm i mirë për qytetarët e komunës dhe për këtë përgëzoi strukturat komunale. Pastaj ceku se është debatuar edhe më herët për lokacionin e ndërtimit të këtij objekti dhe mendon se lokacioni më i mirë ka qenë parcela afér muzeut të qytetit. Lokacioni ku është caktuar të ndërtohet ky objekt në sipërfaqe prej 14 ari është një sipërfaqe jo e mjaftueshme për këtë destinim, pasi që do të ketë mungesë të parkingut për automjete, dhe vështirësi në qasje. Në vazhdim vlerësoi se komuna nuk duhet të kursejë sa i përket hartimit dhe realizimit të këtij projekti ashtu që ta bëjë një objekt sipas udhëzimit administrativ, duke respektuar standartet e

kërkua. Pastaj objekti ku ndodhet aktualisht QMF-ja i cili do të kalojë në administrimin e ministrisë duhet që për këtë komuna të kompensohet.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se në pjesën e qytetit afër muzeut, ka nevojë që të ndërtohet një objekt shëndetësor (ambulantë), por është joadekuat që në oborrin e muzeut të ndërtohet ky objekt, kur dihet fakti se disa prona prapa muzeut më herët janë privatizuar dhe si komunë nuk kemi një hapësirë që të ndërtojmë në këtë pjesë. Sa i përket lokacionit që është propozuar mund të thuhet se është një lokacion adekuat për shkak të qasjes dhe konfiguracionit të qytetit, sepse qëllimi është që me shërbime shëndetësore të mos ngulfatet qyteti dhe po ashtu shërbimet shëndetësore të mos jenë larg qendrës së qytetit. Dhe kështu me dy objekte, Qendra të mjekësisë familjare do të kemi ofrim të shërbimeve cilësore shëndetësore. Mandej ai shtoi se ai pajtohet me qasjen që Ministria e Shëndetësisë të rrisë investimet në komunën tonë përfaktin se komuna i ka ofruar kësaj të fundit shumë prona ndër to edhe pronën ku është ndërtuar spitali i qytetit. Objekti aktual i Qendrës së mjekësisë familjare nuk do të rrënohen, por do të shndërrohen në ambulantë specialistike të spitalit. Në kontekst të investimeve dhe ndërtimit të këtij objekti, ai ftoi grupin kuvendar të PDK-së që ta përkrahin këtë projekt në Ministrinë e Shëndetësisë, pasi që kjo e fundit udhëhiqet nga PDK-ja dhe ftoi që kërkesën përfaktit ta nënshkruajnë bashkërisht me qëllim që përfaktit projekt mos të ketë zgjatje dhe pengesa gjatë realizimit. Ministria e Shëndetësisë i ka hequr nga buxheti 160 mijë euro të huamarjes dhe kjo është bërë në mënyrë të kundërligjshme, ku përfaktit zyrtarisht është kërkuar nga ministria që të kthehen këto mjete. Përfaktit e QMF-së, organizata "Gjysmëhëna e Kuqe" nga Emiratet e Bashkuara, ka shprehur gatishmëri përfaktimin e këtij objekti, dhe shpresojmë që ministria dhe organizata në fjalë do të na ndihmojnë përfundimin sa më të shpejtë të këtij objekti.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – pyeti se ish-objekti i TMK-së a do të rrënohen përfaktimin e QMF-së, pasi që sipërfaqja prej 14 arë është duke e përfshirë edhe objektin e cekur, përndryshe nëse ai objekt nuk rrënohen aty nuk do të ketë sipërfaqe të mjaftueshme përfaktimin e asaj qendre.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanim vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni përfaktimin e objektit të Qendrës të Mjekësisë Familjare në Vushtrri, në pjesë të parcelës kadastrale P-70202016-02358-12, në sipërfaqe prej 1400 m², nga sipërfaqja e përgjithshme prej 41655 m², Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria përfaktësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria përfaktë Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përfaktë Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit përfaktimin/ transferin e mjeteve.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë "unanime" vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet transferimi i mjeteve financiare nga fondi dhjetë (10), paga dhe mëditje, programi administrativ me kod të programit 16324, në shumën prej pesë mijë

euro (5,000.00 €), të cilat transferohen në programin zyra e kuvendit komunal, me kod të programit 16924.

2. Nga programi buxhetimi, me kod të programit 17524, paga dhe mëditje, shuma e mjeteve financiare prej një mijë euro (1,000.00 €), transferohen në programin me kod 75616 shërbimet sociale.

3. Nga programi arsimi i mesëm, kodi ekonomik 94890, paga dhe mëditje, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej gjashtë mijë € (6,000.00 €), transferohen në programin me kod ekonomik 92670 arsimi parafillor dhe çerdhet.

4. Transferimi i mjeteve financiare në kuadër të programit infrastruktura publike, me kod të programit 18184, foni 21, nga kategoria mallra dhe shërbime, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej katërdhjetë mijë euro (40,000.00 €), transferohen në kategorinë shpenzime komunale.

5. Në kuadër të shpenzimeve kapitale, planifikimi urban dhe inspeksioni, kodi i programit 66425, kodi funksional 0620, foni dhjetë (10) nga projektet:

- 5.1 Asfaltimi i rrugëve në Pantinë me kod 45874, shuma e mjeteve (11,675.00€);
- 5.2 Asfaltimi i rrugëve në Balincë me kod 47046, shuma e mjeteve (947.12 €);
- 5.3 Asfaltimi i rrugëve në Sllakoc me kod 45627, shuma e mjeteve (5,252.00€);
- 5.4 Asfaltimi i rrugëve në Beçuk me kod 43918, shuma e mjeteve (1,292.25€).

6. Mjetet financiare të cekura në pikën pesë (5) të këtij vendimi në vlerë prej 19,166.37 €, rialokohen në projektin asfaltimi i rrugëve në Navolan kodi i programit 43916.

7. Shpenzimet kapitale nga projektet:

- 7.1 Asfaltimi i rrugëve në Ceceli me kod 46861, shuma e mjeteve (3,972.50€);
- 7.2 Asfaltimi i rrugëve në Pestovë me kod 46948, shuma e mjeteve (4,199.50€);
- 7.3 Asfaltimi i rrugëve në Stroc me kod 47036, shuma e mjeteve (2,401.50€).

8. Mjetet financiare të cekura në pikën shtatë (7) të këtij vendimi në vlerë prej 10,573.50 €, rialokohen në projektin me kod ekonomik 46848 asfaltimi i rrugëve në tri Dumnicat.

9. Nga projekti asfaltimi i rrugëve në Ropicë, kodi ekonomik 46854, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 2,855.50 €, rialokohen në projektin asfaltimi i rrugëve në Stanoc (kodi i ri ekonomik).

10. Në kuadër të infrastrukturës publike, kodi i programit 18184, kodi funksional (0451), nga projekti ndërtimi i trotuareve, me kod 41407, shuma e mjeteve financiare prej 10,699.13 €, rialokohet në projektin “Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni ” kodi i projektit 41406.

11. Nga shërbimet sociale, kodi i programit 75616, kodi funksional 1040 nga projekti “Adaptimi i dy zyrave” me kod 46923, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro (1,699.00 €), rialokohen në projektin inventar për zyra, kodi i ri ekonomik, shuma e mjeteve financiare një mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë euro (1,699.00 €).

12. Nga arsimi fillor, me kod të programit 93690, kodi funksional 0912, nga projekti “Ndërtimi i shkollës filllore në Beçuk”, me kod 46698, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 13,278. 90 €, rialokohen në projektin “Ndërtimi i punëtorisë dhe kabinetave në shkollën teknike” me kod 46561 (arsimi i mesëm me kod të programit 94890, kodi funksional 0922).

13. Asfaltimi i rrugëve në Maxhunaj me kod 43923, shuma e mjeteve (14,961.00€), rialokohen në projektin “asfaltimi i rrugëve në Maxhunaj” me kod të projektit 43923 shuma e mjeteve financiare 14,961.00 €.

14. Planifikimi urban nga fondi 21 nga projektet:

14.1. Asfaltimi i rrugëve në Bukosh me kod 46966, shuma e mjeteve financiare 4,972.50 €;

15. Nga projektet:

15.1. Asfaltimi i rrugëve në Vërnice me kod 46983, shuma e mjeteve financiare në vlerë 2,200.87 €;

15.2. Asfaltimi i rrugëve në Beçuk me kod 43918, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 5,200.00 €.

16. Shuma e mjeteve financiare të cekura në pikën 15, në vlerë prej 7,400, 87 € rialokohen në projektin ”Asfaltimi i rrugëve në Stanoc” (kodi i ri ekonomik).

17. Asfaltimi i rrugëve në Balincë me kod 47046, shuma e mjeteve financiare 10,000.00€, rialokohet në projektin ”Asfaltimi i rrugëve në Novolan” me kod të projektit 43916, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 10,000.00 €.

18. Në kuadër të infrastrukturës publike, kodi i programit 18184, kodi funksional (0451), nga projekti ”Projektet në bashkëfinancim me donatorë” me kod 43900, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 6,000.00€, rialokohen në projektin ”Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni” me kod 41406.

19. Nga bujqësia me kod të programit 47024, kodi funksional 0421 nga projekti ”Makina për konzervimin e barit (rrotoballer) me kod 46718, shuma e mjeteve financiare prej 2,100.00 €, rialokohet në projektin ”Ndërtimi i serrave” me kod 43903.

20. Nga fondi 22 planifikimi urban dhe inspeksioni, kodi i programit 66425, kodi funksional 0620, nga projekti ”Asfaltimi i rrugës Hasan Tiku Shabani” me kod 45491, shuma e mjeteve financiare në vlerë prej 2,985.22 €, rialokohen në projektin ”Asfaltimi i rrugës Emin Uka” Banjskë, me kod 45775.

21. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

7. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Hartës zonale

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se Komuna e Vushtrrisë për realizmin e projektit hartimi i Hartës zonale ka hyrë në partneritet me UN-Habitat, ku ka përfituar një donacion prej

120,000.00 € dhe bashkë edhe me 80,000.000 € tjera do të hartohet Harta zonale në bashkëpunim me agjencitë e specializuara dhe MMPHN, ku do të përfshihet edhe zona historike e qytetit të Vushtrrisë dhe kjo hartë do të bëhet në përputhje me PZHK-në ku në fund pas të gjitha diskutimeve që do të zhvillohen, ky projekt do të aprovohet nga ana e kuvendit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

Pika 1
Lloji i dokumentit të planifikuar hapësinor

Me këtë vendim fillohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Vushtrrisë.

Pika 2
Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinor Harta zonale e komunës, në harmoni me ligjin, si dokument multi-sektorial përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit, përcakton hollësishëm llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit, të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e komunës, për periudhën tetëvjeçare.

Pika 3
Qëllimi i hartimit

Me Hartën Zonale të Komunës së Vushtrrisë nga nen 1 i këtij vendimi, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe zonën rurale, në kontekst të ndryshimeve të bëra, harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit të Komunës së Vushtrrisë, plotësohen kërkesat ligjore për rregullimin e zhvillimeve në zonën urbane dhe zonën rurale.

Pika 4
Kufiri i territorit

Zona kadastrale të përfshira në territorin e Komunës së Vushtrrisë janë:

Nr.	Emërtimi (vendbanimi)	Kodi i zonës kadastrale	Nr. i parcelës	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Nr. i banorëve rezidentë sipas regj. 2011
1	Balincë	70202002	828	28,199.32	323
2	Banjskë	70202003	647	36,102.44	891
3	Beçiq	70215006	515	32,942.89	227
4	Beçuk	70202005	1289	72,914.53	487
5	Bivolak	70202006	1477	30,229.60	730
6	Boshlan	70202007	536	42,314.78	5
7	Brusnik	70202009	803	72,967.75	404
8	Bukosh	70202010	1610	58,244.77	1,171
9	Ceceli	70202068	1530	79,624.46	357
10	Dobrëlluk	70202024	1228	281,964.49	1,629
11	Dalak	70202025	512	10,869.91	786
12	Dumnicë e Poshtme	70202026	1950	67,825.88	1,379
13	Studime e Poshtme	70202027	1154	42,853.54	777
14	Stanoc i Poshtëm	70202028	1582	34,607.94	1,736
15	Sfaraçak i Poshtëm	70202029	892	46,659.48	875
16	Druar	70202030	1750	82,108.75	965
17	Duboc	70202032	2334	98,765.50	493
18	Galicë	70215013	1191	44,323.50	234
19	Gllavatin	70202017	822	26,564.76	391
20	Gojbulë	70202018	1502	68,009.76	588
21	Studime e Epërme	70202020	1132	72,424.30	335
22	Stanoc i Epërm	70202021	2266	80,894.67	2,501
23	Gracë	70202022	1680	45,780.54	424
24	Gumnishtë	70202023	1252	97,510.94	65
25	Hercegovë	70202067	558	43,384.35	423
26	Jezer	70202035	820	41,510.05	318
27	Karaçë	70202036	731	30,409.49	192
28	Kollë	70202037	1052	71,847.96	554
29	Kunovik	70202038	387	17,019.57	13
30	Kurillovë	70202039	414	50,636.91	14
31	Dumnicë e Llugës	70202040	1631	71,898.14	656
32	Mihaliq	70202041	2497	11,7138.89	1,242
33	Miraçë	70202042	649	27,162.67	10
34	Nedakoc	70202043	363	7,199.11	268
35	Novolan	70202044	2156	72,740.02	1,366
36	Begaj	70202045	460	21,794.32	1,261
37	Maxhunaj	70202046	2264	58,707.06	2,035
38	Akrashticë	70202047	1057	38,955.35	1,113
39	Oshlan	70202048	1718	43,785.33	488
40	Pantinë	70202049	1523	46,848.18	1,422
41	Pasomë	70202050	1692	63,395.41	744
42	Pestovë	70202051	1679	39,322.18	842
43	Prelluzhë	70202053	1673	75,034.58	558
44	Reznik	70202054	1221	35,653.83	1,366
45	Ropicë	70202055	380	9,663.26	763

46	Shalë	70202069	1358	72,384.01	541
47	Samadrexhë	70202056	2498	113,542.23	1,321
48	Skoçan	70202058	784	47,914.85	5
49	Skromë	70202059	1316	69,267.63	114
50	Sllakoc	70202060	721	77,707.75	263
51	Sllatinë	70202061	990	42,042.42	491
52	Shlivovicë	70202070	768	61,379.62	14
53	Smrekonicë	70202062	1348	39,824.67	1,646
54	Shtitaricë	70202071	832	17,751.51	788
55	Stroc	70202063	1461	57,887.55	865
56	Taraxhë	70202064	412	27,097.54	54
57	Tërllobuq	70202065	904	37,319.76	125
58	Lumadh	70202011	911	19,221.09	1,017
59	Vesekoc	70202013	508	89,524.28	40
60	Vilanc	70202014	717	23,045.48	387
61	Vërnice	70202015	1325	42,407.83	612
62	Vushtrri	70202016	11379	169,315.87	26,964
63	Zagorë	70202034	601	38,805.91	18
64	Zhilivodë	70202033	1182	47,006.54	496
65	Dumnice e Epërme*	70202019	1116	69,754.06	284

*Sipas dokumenteve zyrtare të dërguara më datë 7.6.2018 nga Agjensia Kadastrale e Kosovës (shih dokumentin e bashkëngjitur), në të gjitha sistemet, duke filluar prej viteve 1983-1988 e deri më tanj, zona kadastrale Dumnice e Epërme ka ekzistuar dhe ekziston si zonë kadastrale, ka kodin unik të zonës kadastrale 70202019, në kuadër të territorit të Komunës së Vushtrrisë. Mirëpo gjatë hartimit të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, fshati Dumnice e Epërme është harruar të futet në listë. Në momentin kur fillon procesi i plotësim/ndryshimit të këtij ligji, Komuna e Vushtrrisë do të paraqesë kërkesën zyrtare në ministrinë përkatëse për inkorporimin e këtij fshati (Dumnice e Epërme) në kuadër të listës.

Pika 5 Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Hartës zonale të komunës caktohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Pika 6 Mjetet dhe mekanizmat e nevojshme për hartim

Mjetet për hartimin e dokumentit të planifikimit hapësinor sigurohen nga buxheti i Komunës së Vushtrrisë.

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, pika 1.5.1 e Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit koordinon procesin e hartimit të Hartës zonale të komunës me drejtoritë sektoriale, burimet njerëzore brenda komunës, si dhe me ekipin e organizatës mbështetëse (UN-Habitat) sipas Memorandumit të Mirëkuptimit të datës 19.4.2018, nënshkruar në mes të Komunës së Vushtrrisë, UN-Habitat dhe PAX.

Pika 7 Afati i hartimit

Bartësi i hartimit të dokumentit të planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i obliguar që Hartën zonale të komunës ta hartojë në afat prej 24 (njëzet e katër) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Pika 8 Konsultimet publike

Projekti i Hartës Zonale të Kosovës para finalizimit duhet të vihet në konsultime publike dhe në shqyrtim publik. Paraqitja e Projekt-hartës zonale të komunës në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen përmes njoftimeve publike.

Pika 9 Afati i vlefshmërisë

Harta zonale e komunës hartohet për një periudhë tetëvjeçare (8).

Pika 10 Gjuha zyrtare

Dokumenti i planifikimit hapësinor sipas nenit 1 të këtij vendimi duhet të jetë në gjuhët zyrtare të komunës dhe së paku në 3 kopje të shtypura e të vulosura dhe 3 kopje digjitale të originalit.

Pika 11 Programi

Pjesë e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë me nenin 11, pika 1.3 e Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr.04/L-174.

Pika 12

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 192/15, datë 29.9.2015, i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për Hartimin e Hartës Zonale në Komunën e Vushtrrisë dhe Vendimi nr.234/17 i datës 23/07/2017 për zgjatjen e afatit të projektit nga njëvjeçar në projekt dyvjeçar për Hartimin e Hartës Zonale në Komunën e Vushtrrisë.

Pika 13 Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e rrugës së re me emrin e „Shkelzen Sylës”

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim aprovohet kërkesa për shkëputjen e një segmenti sekondar nga rruga „Sadako Ogata”, formimi i rrugës së re dhe emërtimi i saj me emrin e „Shkelzen Sylës”

me kod të ri 11412 e cila rrugë gjendet në lagjen Syla në fshatin Reznik.

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

c). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon: aprovohet në parim propozim-vendimi

1.Me këtë vendim, lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të komunës - Qendra për Qëndrim Ditor për Fëmijë me Nevoja të Veçanta në fshatin Nedakoc dhe hapësirës së nevojshme përreth objektit e cila gjendet në ngastrën kadastrale P-70202043-0011-1, në sipërfaqe prej 1109 m² (objekti dhe sipërfaqja përreth objektit), Zona Kadastrale Nedakoc.

2.Prona e paluajtshme e cekur në pikën 1 të këtij vendimi jepet në shfrytëzim afatshkurtër, pa kompensim, në kohëzgjatje prej _____ vitesh, Organizatës joqeveritare të specializuar përofrim të shërbimeve profesionale përfëmijë me nevoja të veçanta.

3.Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë regjistrimin e paluajtshmërisë e cila jepet në shfrytëzim, në regjistrin kadastral.

4.Obligohet Komisioni për vlerësim të ofertës përdhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, që të zhvillojë procedurat përshtatshme, të cilën ia dërgon Kryetarit të komunës përlidhje kontratës.

5.Komuna rezervon të drejtën që në çdo kohë të shkëpusë në mënyrë të njëanshme kontratën nëse një gjë të tillë e kërkon interesit i përgjithshëm.

6.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

ç). Shqyrtimi i Informatës përfundimin e vitit shkollor 2017/2018 dhe përgatitjet përfillimin e vitit shkollor 2018/2019

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - pyeti drejtorin e arsimit lidhur me sigurimin e transportit të nxënësve në 19 linja të Komunës së Vushtrrisë, si dhe përsigurimin e 14 linjave, të cilat janë në procedurë të prokurimit, ku adresoi kërkesat e banorëve të fshatrave: Gracë dhe Ropicë ku kanë kërkuar informatë se përsë deri më tanë nuk është siguruar transporti përfëmijët e tyre ashtu siç ka qenë i siguruar më herët. Andaj në kontekst të kësaj pyeti drejtorin e arsimit se cilat janë ato 19 linja që janë vendosur që të bëhet transportimi i nxënësve, si dhe kur do të mund të përfundonte procedura e prokurimit përf 14 linja tjera të transportit. Pastaj kërkoi nga Drejtoria e Arsimit raport me shkrim lidhur me kandidatët e pranuar në konkursin e fundit në lëmin e

arsimit nga muaji qershor e deri më sot, mandej kërroi që në raport të ceket se përse nuk janë ftuar në intervistë kandidatët që kanë qenë me kualifikim adekuat, por ka pasur kandidatë që janë ftuar në intervistë që kanë qenë të një drejtimi krejt tjetër për një vend pune që është kërkuar tjetër lloj i përgatitjes profesionale. Gjithashtu në kuadër të fushës së arsimit kërroi nga drejtoria kompetente të ofrojë raport me shkrim lidhur me transferin e mësimdhënësve nga një shkollë në një shkollë tjetër (të ceket numri i mësimdhënësve që janë transferuar nëpër shkolla gjatë vitit 2018), pastaj pyeti se përse nuk janë shpallur orët mësimore të profesorësh së ndjerë znj. Selime Zushi në shkollën SHMU-2 dhe të profesorit të ndjerë z.Nazmi Klinaku në gjimnaz.

Melihate Basholli, anëtar e kuvendit – tha se pajtohet me idenë që kjo informatë në të ardhmen të vjen para kuvendit në muajin tetor me qëllim që të përgatitet më mirë, pasi që vlerësoi se është hartuar në mënyrë të shpejtë dhe nuk ka lidhje të duhura logjike. Në këtë drejtim ceku se në faqen nr. 4 të informatës thuhet: u trajnuan 9 koordinatorë për testin pisa, pastaj thuhet “si edhe nëntë drejtorë të shkollave” dhe kështu nuk dihet se a janë trajnuar këta drejtorë për udhëheqje apo për testin pisa, këtu kemi një ndarje të fjalisë dhe kjo ka bërë që kësaj fjalie t'i humb kuptimi. Tutje në faqen 6 tek aktivitetet jashtëkurrikulare, pyeti se në cilat organizime të aktiviteteve cilat shkolla kanë marrë pjesë, a janë pjesëmarrëse shkollat e fshatrave apo vetëm ato të qytetit. Shpërndaja e teksteve mësimore është bërë në fillim të vitit shkollore, porse disa tekste nuk janë shpërndarë pasi që ato mungojnë. Në faqe numër 10 ceket se është rinouar një shkollë në vlerë prej 9,000.00 € por nuk ceket ku ndodhet ajo shkollë. Në fund apeloi për një strategji përmirësimin e gjendjes në arsim në kuptimin e ngritjes së cilësisë.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – kërroi që shkolla në fshatin Beçiq të futet në planifikim, renovimi dhe ndërtimi i rrrethojës, pasi që bagëtitë futen në oborr të shkollës dhe shkaktojnë dëme.

Lorik Maxhuni, anëtar i kuvendit – shprehu shqetësimin e banorëve të fshatit Stanoc i Poshtëm pasi që atje tash e sa ditë nuk ka filluar procesi mësimor, për faktin se është duke u rinouar shkolla. Tutje ai adresoi shqetësimin e tij për devijim të projektit ku paramasat janë marrë gabim, stiropori nuk është shtruar, por është bërë nivelizmi pa stiropor dhe për të gjitha këto duhet iniciuar rasti dhe dikush duhet të përgjigjet penalisht. Gjithashtu ai tha se në konkursin e fundit në Drejtorinë e Arsimit janë punësuar militantë partiakë të partive politike dhe se studentët shembullorë nuk kanë mundur të punësohen në këto vende pune dhe për këtë duhet të jepet përgjegjësi nga kryetari i komunës dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se edhe përkundër investimeve të bëra në fushën e arsimit, prapëserapë gjendja në arsim nuk mund të thuhet se është e mirë. Lidhur me këtë ai arsyetoi se infrastruktura fizike shkollore është duke u kompletuar dhe tash duhet të investohet në resurse humane, duke zhvilluar politika kadrovike konform udhëzimeve administrative dhe rregulltives ligjore në përgjithësi. Tutje vlerësoi se nëse dikush ka argumente për keqpërdorime në fushën e arsimit ai duhet t'i adresohet organeve kompetente të hetuesisë dhe prokurorisë dhe jo të lëshohet në nivele të ulëta të diskutimit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – pyeti se lidhur me disa individë, të cilët kanë vendosur disa zinxhir në rrrethojat e objektit të komunës, kush janë këta persona dhe për çfarë bëhet fjalë.

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit – tha se është mirë që të jepen informacione para kuvendit për konkursin e fundit në lëmin e arsimit, duke aluduar që mos të kemi implikime politike dhe të mbytet profesionalizmi, duke punësuar militantë partiakë. Pastaj ai gjykoi se askush nuk flet për cilësinë nëpër shkolla, por për shkollën mendohet vetëm në kuptimin e objekteve shkollore, por askush nuk merret se çfarë mësimdhënës i mësojnë fëmijët tanë.

Afrim Namani, drejtor DA-së - paraqiti sqarime lidhur me informatën e arsimit duke u përgjigjur në çështjet e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Andaj në këtë kontekst informoi se në kuadër të arsimit parafillor janë hapur 11 vende të reja të punës ashtu që nga 30% sa ka qenë mbulueshmëria e pagesës së këtyre mësimdhënësve tanë pagesa bëhet në tërë spektrin e kësaj fushe të arsimit të komunës. Pastaj njoftoi se ka qenë kërkësë edhe nga kuvendet e kaluara që të

bëhet pagesa e punëtorëve arsimorë të ciklit parafillor, kurse tani drejtori ka ndjekur një politik ashtu që mësimdhënësit që janë pensionuar, pozitat e tyre nuk janë zëvendësuar, por mësimdhënësit që nuk kanë pasur normë të plotë iu janë plotësuar normat dhe kështu pagat e lira nga këto pozita janë shfrytëzuar për pagesën e mësimdhënëseve të ciklit parafillor.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se gjendja në arsimin e komunës sonë nuk është se e ka shkaktuar qeverisja aktuale, ajo është trashëguar nga e kaluara. Pastaj shtoi se qeveria aktuale është duke bërë përpjekje për përmirësimin e gjendjes në arsim dhe kjo ka filluar me pagesën e mësimdhënësve për parashkollorët ku kjo ka qenë edhe një zotim i qeverisë së tij. Në vazhdim ai ilustroi një shembull duke marrë fshatin Stanoc, ku vitin e kaluar kur mësimi parashkollor bëhej me vetëfinancim nga prindërit kishim vetëm 17 nxënës, kurse tani me financim nga komuna kemi dy klasë në këtë nivel. Kjo në terma tjerë ka ndikuar negativisht në të kaluarën pasi që fëmijët që nuk kanë ndjekur mësimin parashkollor janë nderë inferior karshi nxënësve tjerë. Në kontekst të kësaj, qeverisja aktuale me një menaxhim të mirë ka arritur që 11 vende pune t'i krijojë në ciklin parashkollor dhe ka mundësuar financimin e tyre dhe kështu rrjedhimisht është rritur edhe numri i nxënësve në ciklin parashkollor. Për ta ndryshuar gjendjen në arsim qeveria aktuale ka rritur financimin e arsimit për 43% dhe kjo tregon se arsimi është prioritet për qeverinë aktuale. Për vitin e ardhshëm është planifikuar buxheti për kifle për nxënësit dhe shtoi se ai kishte vizituar fshatin Zhilivodë dhe kishte parë dhe ishte njoftuar që një nxënës në mungesë të mjeteve financiare nuk kishte pasur mundësi që të marrë ushqim (kifle), këtë e kishin financuar bashkëfshatarët dhe ky shembull tregon gjendjen në arsim të cilën e ka trashëguar. Andaj politikat komunale të qeverisë aktuale kanë për qëllim ndryshimet rrënjosore në fushën e arsimit në komunë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se duhet të angazhohemi të gjithë së bashku që të hartojmë politika komunale, të cilat ndikojnë në përmirësimin e gjendjes në arsim. Lidhur me fondin për sigurimin e kiflevë për nxënësit, ceku se kjo është e mirë, porse jo e mjaftueshme për faktin se nxënësit duhet të kenë shujtë të plotë gjatë ditës. Pastaj shtoi se është gjithashtu gjë e mirë rritja e numrit të parashkollorëve pasi cikli parashkollor është bazik në formësimin e personalitetit të fëmijës. Në anën tjetër lirimi i këtyre vendeve të punës në ciklin parashkollor është rezultat i zvogëlimit të përgjithshëm të numrit të nxënësve, e jo i ndjekjes së ndonjë politike të suksesshme komunale. Tutje shtoi se ne rezultatin në letër e kemi të shkëlqyeshëm, porse kjo nuk përkon me realitetin, për faktin se shumë profesorë po i ngritin notat tek nxënësit si rezultat se ata nxënës i mësojnë nëpër kurse private dhe për këtë ata nxënës marrin nota të mira.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se është për keqardhje situata e zhvilluar në kuvend, dhe më për keqardhje është kur një kryetar komune fyeni një anëtar të kuvendit dhe se nuk besoj që dikush ndihet mirë kur kryetari i komunës i drejtohet dikujt me shprehjen “fëmijë”. Tutje shtoi se nuk është mirë që të luhet me ndjenjat e dikujt se kush sa jep dhe nuk e duron dot faktin kur dikush moralizon se nga ardhja në qeverisje të komunës e ka zhdukur varfërinë në komunën tonë. Mandej ai e përsëriti mendimin nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, duke adresuar se i ka treguar faktet për atë se se si kreu i komunës i ka intervistuar disa zyrtarë komunalë të cilët dyshohen se kanë keqpërdorur paranë publike dhe kjo shton dilemën se si kryetar i komunës ka qenë në dijeni për këta zyrtarë (drejtorë) që bëhet fjalë për ta që kanë keqpërdor pozitën publike duke përfituar, kështu që kryetari i komunës nuk mund të na moralizojë. Andaj në fund kërkoi që kryetari i komunës ta tërheq fjalën e tij dhe të kërkojë falje për fyerjen e bërë ndaj anëtarit të kuvendit.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se nëse dikush nga zyrtarët komunalë është i inkriminuar në korrupsion, atëherë ai do të jetë i pari që do ta paraqesë në organet kompetente dhe do ta shkarkojë nga detyra. Nëse dikush fletë për keqpërdorim dhe korrupsion, atëherë për këtë mjafton ta shikojmë objektin afër komunës dhe objektet përreth, të cilat janë bërë në kundërshtim me kriteret ligjore dhe këto janë bërë nga eksponentë të partisë që më herët ishte në pushtet. Dikush këtu është duke e përjetuar rëndë faktin që komuna i mbulon shpenzimet e

për atë ekziston një ligj i prokurimit ku duhet të fitojë oferta më e lirë. Andaj në këtë kontekst duhet që anëtari i kuvendit të kërkojë falje për shpifje. **Besim Muzaqi, nënkyrytar i komunës** – tha se i vjen keq që debati u ulë deri në atë pikë dhe shtoi se ndihet mirë që kryetari i komunës kërkoi ndjesë për ndonjë llapsus eventual.

Mbledhja përfundoi në ora 12:40.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

